

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e Studimit Bachelor në:“Ekonomi”me profile:

- **Banka dhe institucione financiare;**
- **Administrim Biznesi;**
- **Financë Kontabilitet;**

Ofruar nga Kolegji Universitar “I Biznesit”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Sherif BUNDO

Prof. Asoc. Dr. Ana KAPAJ

(Tetor / 2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bsc në “Ekonomi” me profile:

- **Banka dhe institucione financiare;**
- **Administrim Biznesi;**
- **Financë Kontabilitet;**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Koleji Universitar “ I Biznesit”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	Urdhër Nr. 500, date 18.10.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Ekonomi” me profile: <ul style="list-style-type: none">• Banka dhe institucione financiare;• Administrim Biznesi;• Financë Kontabilitet
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
	Numri i studentëve	369
	Profili Financë Kontabilitet; 203 studentë	
	Profili Administrim Biznes; 155 studentë	
	Profili Banka dhe institucione financiare; 11 studentë	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile: Banka dhe institucione financiare; Administrim Biznesi; dhe FinancëKontabilitet.

Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB) është një institucion i arsimit të lartë jopublik. Ai ka filluar aktivitetin e tij si Akademia Profesionale e Biznesit (APB) me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 651 datë 14.09.2011, dhe me urdhër Nr.3 datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Lejimin e veprimtarisë akademike të programeve të studimit”, ka filluar procesin e arsimimit e të kërkimit shkencor në të dy ciklet e studimit, ciklin Bachelor dhe Master. Në përbërjen e tij janë 2 njesi themelore; Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Drejtësisë. Ky institucion ka marrë akreditimin institucional me urdhër nr 557 datë 16.11.2012 të MASH, si Akademia Profesionale e Biznesit dhe është riakredituar me VBA nr. 100 datë 10.11.2017 po si Akademia Profesionale e Biznesit.

Si rezultat i standartizimit të strukturës akademike, në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” me urdhër të MASR nr. 39, datë 30.01.2018 “MIRATIMIN E STATUTIT TE KOLEGJIT UNIVERISTAR “I BIZNESIT”, Akademia Profesionale e Biznesit merr emrin Kolegji Universitar “I Biznesit”.

Aktualisht, KUB ofron programe studimi dhe lëshon diplomën përkatëse në:

a) Ciklin e parë të studimeve (Bachelor),

- Bachelor, në Fakultetin e Ekonomisë, që përgatit specialistë të fushës së ekonomisë për Financë dhe Kontabilitet, në fushën e Administrimit të Biznesit dhe për drejtimin e Bankave dhe Institucioneve Financiare.
- Bachelor, në Fakultetin e Drejtësisë, që përgatit specialistë në fushën e shkencave juridike, juristë me një kulturë të konsoliduar në Drejtësi, dhe në të Drejtën e Biznesit.

b) Ciklin e dytë të studimeve (MP, Msc)

- Master Shkencor, në Fakultetin e Ekonomisë, që përgatit ekspert e studiues të pavarur në fushat e Kontabilitetit dhe të Financës dhe të Menaxhim Biznesit.
- Master i Shkencave në fushën e Drejtësisë, duke përgatitur ekspert dhe studiues në fushën e shkencave juridike, si penalistë, civilistë dhe juristë të së drejtës tregtare.
- Master Profesional, në Fakultetin e Ekonomisë, duke përgatitur specialistë të profilizuar në fushat e Kontabilitetit dhe të Financës dhe të Menaxhim Biznesit.

Pasi u konsultua me Rregulloren e Programit dhe bisedat me stafin, studentët dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se në përfundim të këtij programi studimi, studenti do të jenë i aftë:

- Të marrë njohuritë mbi bazën e arsimit paraardhës të tyre,
- Të ketë një informim teorik dhe profesional të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën e ardhshme,
- Të pajiset me njohuri teorike dhe praktike mbi mënyrat dhe metodat e menaxhimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit, njohuri mbi mënyrat dhe metodat e kontabilitetit, njohuri mbi sistemin bankar dhe institucionet financiare
- Të marrë trajnim për kërkim shkencor fillestar nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të kërkimit.

Programet e studimit në KUB janë të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ato nxisin lëvizshmërinë akademike edhe tek partnerët tanë jashtë vendit. Mbështetur në statutin e tij, Misioni

i KUB, ka qenë e mbetet mbështetja e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, me specialist të aftë për fushat më të rëndësishme të shërbimeve publike. KUB, me urdhër Nr. 139 datë 23.03.2018 të MASR, hap njësinë e re kryesore “Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale” me strukturën më poshtë:

Departamenti i Studimeve të Larta Administrative;

Departamenti i Studimeve të Larta Teknike;

duke filluar aktivitetin në vitin akademik 2018-2019 në dy programe profesionale me profile, në fushën administrative dhe teknike.

Të gjitha programet mësimore të ofruara nga **Fakulteti i Ekonomisë (FE)**, pranë KUB-it, janë të akredituara, bazuar në Urdhërin Nr. 500 datë 18.10.2012 të Ministrit Arsimit dhe Shkencës “Për akreditimin e programeve të studimit Bachelor në “Drejtesi”, **Bachelor në “Ekonomi”**; Master Profesional në “Kontabilitet Financë” dhe “Menaxhim Biznesi”; në Urdhërin Nr. 553 datë 23.11.2016 Për Akreditimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në Kontabilitet Financë”; në Urdhërin Nr. 562 datë 30.11.2016 Për Akreditimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi”.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Dr. Sherif BUNDO

Prof. Asoc. Dr. Ana KAPAJ.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit janë asistuar nga specialistia e ASCAL Znj. Majlinda DEMIRNELI.

Kolegji Universitar “I Biznesit” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.10.2018, përmes sistemit AMS. KUB përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 542 Prot, datë 17.10.2018 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet kësaj shkrese Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit sipas VKA Nr. 364, datë 17.09.2012

1. Të merren masa për të ndërtuar terrene të jashtme për qëndrimin dhe pushimin e studentëve
2. Të bëhet më shumë punë për kërkimin shkencor.
- ~~3. Të realizohen botime nga stafi i angazhuar në këtë institucion.~~

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) KUB e ka përmirësuar infrastrukturën e institucionit. Kjo vihet re në shtimin e ambienteve të brendshme të IAL, me sallat e reja të mësimit, si edhe me gjetjen e një vendi për parkim pranë godinës kryesore. Gjithashtu gjatë vizitës së realizuar në IAL, GVJ u informua se KUB ka marë edhe një ambient tjetër pranë atij aktual për të plotësuar më mirë nevojat e tij. Për rekomandimin “*Të merren masa për të ndërtuar terrene të jashtme për qëndrimin dhe pushimin e studentëve*”, institucioni ka punuar dhe **plotësuar këtë rekomandim.**

- b) Rritja e nivelit të kërkimit shkencor ka qënë një prioritet i institucionit. KUB nga vitet 2012-2018 është angazhuar vazhdimisht për të ndjekur maksimalisht shkallët e kualifikimit shkencor për t'u përfshirë në punën kërkimore shkencore në funksion të procesit mësimor dhe në të mirë të ekonomisë së vendit. KUB ka realizuar në mjediset e saj: 4 Konferenca Ndërkombëtare, 5 Konferenca Kombëtare, 2 Konferenca Kombëtare Studentore, Botimin e dy numrave të Revistës Ndërkombëtare Shkencore "Revista Shkencore e Studimeve Profesionale" me ISSN 2412-5865. Për rekomandimin "Të bëhet më shumë punë për kërkimin shkencor", institucioni ka punuar dhe **plotësuar këtë rekomandim.**
- c) Staf i KUB është i angazhuar në punën shkencore dhe botuese botimeve si: Botime në Revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit; Konferencat shkencore të organizuara nga KUB në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë; Botime tekstesh mësimore dhe shkencore etj. KUB, ka realizuar në mjediset e saj: 4 Konferenca Ndërkombëtare, 5 Konferenca Kombëtare, Botimin e dy numrave të Revistës Ndërkombëtare Shkencore "Revista Shkencore e Studimeve Profesionale" me ISSN 2412-5865 me portal të dedikuar në faqene e saj Web, 2 Konferenca Kombëtare Studentore. Gjatë takimeve me stafin u konstatuan raste kur IAL mbështet stafin e saj për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare apo botime në revista shkencore. Për rekomandimin "Të realizohen botime nga stafi i angazhuar në këtë institucion", institucioni ka punuar dhe **plotësuar këtë rekomandim.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit në kuadrin e Ciklit të Parë Bachelor në "Ekonomi", me profile: Financë-Kontabilitet, Administrim Biznesi, dhe Banka dhe institucione financiare, ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë (FE) pranë Kolegjit Universitar "I Biznesit". Programi ka ngarkesë totale me 180 kredite ECTS dhe është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky program studimi filloi të ofrohet për herë të parë në vitin 2012. Programi ka qënë në vëmendje të punës akademike dhe shkencore të departamentit dhe të fakultetit për të ofruar vazhdimisht elementë të përmirësuar në të dhe për t'u përshtatur me kurrikulat bashkëkohore nga universitete të njohura në Europë dhe në botë.

Bazuar në dokumentacionin, Statutin, RVB dhe vizitën në institucion, Vizioni dhe Misioni i FE/KUB janë si më poshtë.

Vizioni është që programi të zhvillohet në vazhdimësi, me synimin për përgatitjen cilësore të specialistëve të ekonomisë në fushat e Bankave dhe Institucione Financiare; Financë Kontabilitet; dhe Administrim Biznesit. Në përmbushje të këtij vizioni, drejtimet ose synimet kryesore të aktiviteteve edukative, mësimore dhe shkencore, janë:

- Të edukojë dhe të përgatisë studentë në fushën e ekonomisë me qëllim që ata të bëhen "Liderë të mendimit dhe të veprimit", specialistë të profileve përkatëse të ekonomisë, të zhvillojë mendimin kritik dhe krijues me qëllim që ata të kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve dhe shoqërisë shqiptare mbi bazën e njohurive dhe përgjegjësi etike dhe profesionale.

- Të luajë një rol aktiv në zhvillimet dhe proceset ekonomike të vendit duke i dhënë prioritet arritjeve të standardeve evropiane të arsimit të lartë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Misioni është në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Shqipëri, i cili përcaktohet në Ligjin Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RP". Në mënyrë më specifike misioni i programit të studimit është:

- Të zhvillojë, të transmetojë dhe të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që u ofrohen studentëve.
- Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e ekonomisë.
- T'u ofrojë mundësi studentëve që të jenë të përgatitur për t'iu përshatur kërkesave dinamike të biznesit në ekonominë e lirë të tregut, duke "mësuar gjatë gjithë jetës".

Referuar RVB, si edhe informacionit të marrë, gjatë vizitës në institucion, objektivi kryesor i programit është transmetimi te studentët i njohurive bashkëkohore në fushën e ekonomisë, në mbështetje të qëllimit, vizionit dhe misionit të IAL, për të përgatitur specialistë "liderë të mendimit dhe të veprimit" të profileve të kontabilitet-financës, administrimit të biznesit, bankave dhe institucioneve financiare, që të mund të kontribuojnë në sektorin publik e privat dhe njëkohësisht të jenë qytetar aktiv në jetën e tyre të përditshme. Ky program i drejtohet gjithashtu individëve, të cilët duan t'i japin një hov cilësor karrierës së tyre, nëpërmjet thellimit të dijeve dhe aftësive në këtë fushë studimi por edhe në akademi me synimin e vazhdimit të ciklit të dytë të studimeve pas përfundimit me sukses të këtij programi. Veprimtaria e KUB-it bazohet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit, Rregullores Bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit, Bachelor në "Ekonomi" me profile: Financë-Kontabilitet, Administrim Biznesi, Banka dhe Institucione Financiare, ofruar pranë Kolegjit Universitar "I Biznesit", është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Ky program studimi ka objektiva të qartë për formimin e studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përgatisë specialistë të aftë të fushës së menaxhimit të biznesit, financë kontabilitetit dhe bankave dhe institucioneve financiare, e mundësuar kjo përmes kurrikulës së studimeve, e cila ofron për studentët njohje të teorive më të përditësuar të profileve përkatëse, njohje dhe përdorim shumë të mirë të metodave sasore të studimit, si dhe një formim të thellë profesional.

	<ul style="list-style-type: none"> • Të pajisë këta specialistë me teknikat, instrumentet dhe metodat më bashkëkohore (sasiore dhe cilësore), përmes të cilave ofrohen zgjidhje për probleme të ekonomisë. • Të pajisë këta specialistë me njohuritë më të avancuara në fushën e studimit për të mundësuar kështu përgjigje adekuatë ndaj kërkesave të ekonomisë dhe tregut të punës dhe të burimeve njerëzore e kapitale, në kuadër të integritimit Europian të vendit. • T'u mundësojë këtyre specialistëve karrierë të suksesshme dhe kualifikim të mëtejshëm. <p>GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se programi i studimit bachelor në “Ekonomi” me profile, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Për këtë qëllim KUB herë pas here realizon studime tregu për të parë se cilat janë nevojat e punës dhe në përputhje me të ofron syllabuset e programit duke përafuar sa të jetë e mundur përmbajtjen teorike me vlerat praktike.</p> <p>(Dokument mbështetës, Nr. Studimi i tregut)</p> <p>Programi i studimit, bachelor në “Ekonomi” me profile, është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare, fokusohet me së shumti në bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë domosdoshmëri manaxhimin e tyre në mënyrë profesionale, që të mbijetojnë në këtë mjedis shumë dinamik dhe kompleks dhe në këtë kuadër specialistët në Financë-Kontabilitet, Administrim Biznesi, Banka dhe Institucione Financiare janë një nevojë e domosdoshme.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>GVJ referuar këtij dokumentit të strategjisë së kërkimit shkencor, siguruar nga vizita në institucion, konstaton se programi i studimit bachelor në “Ekonomi” me profile, është në përputhje me strategjinë dhe drejtimet e mëdha institucionale të përcaktuara nga KUB.</p> <p>Bazuar në RVB, “Programi Bsc në “Ekonomi” me profile është ndërtuar në përputhje me Dokumentin e Bolonjës; Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Asimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin e AL Nr. 80/2015 dhe Udhëzimin Nr.15 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe kërkesave</p>

	të kohës”. Bazuar në kurikulën e studimeve të këtij cikli studimesh, GVJ konstaton se ky program synon të pajisë studentët me njohuri bazë, si dhe njohuri specifike dhe të vacanta në përputhje me profilin që studentët do të ndjekin.
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Sic dhe u përmend më sipër, KUB herë pas here realizon studime tregu për të parë se cilat janë nevojat e punës dhe në përputhje me të ofron syllabuset e programit duke përafëruar sa të jetë e mundur përmbajtjen teorike me vlerat praktike. (Dokument mbështetës, Studimi i tregut)</p> <p>Çdo fillim viti, KUB/FE formulon propozimin për kuotat e pranimit(Dokument mbështetës, “Shkresa drejtuar MAS për kuotat për vitin akademik 2017-2018”) të studentëve në programin Bsc në “Ekonomi” me profile për vitin akademik pasardhës. Parashikimi mbështetet në studimin e tregut të punës dhe analizën e trendeve të regjistrimeve ndër vite.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit bachelor në “Ekonomi”, me profile, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ai nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Gjithashtu ky program studimi, bachelor në “Ekonomi”, me profile: pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>KUB, ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi”, me profile: Financë Kontabilitet, Administrim Biznesi, Banka dhe institucione financiare, është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit, si dhe në përputhje me nevojat e tregut. Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile: Financë-Kontabilitet, Administrim Biznesi, Banka dhe institucione financiare ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. KUB harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit Bachelor në“Ekonomi”, me profile: Financë Kontabilitet, Administrim Biznesi, Banka dhe institucione financiare zhvillohet pranë Fakultetit të Ekonomisë, në KUB.

Ky Fakultet organizohet në tre njësi bazë që janë:

1. Departamenti i Menaxhimit;
2. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
3. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës.

Programi i studimit ofrohet nga departamentet e Fakultetit të Ekonomisë sipas profileve:

Banka dhe institucione financiare *Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit*
Administrim Biznesi *Departamenti i Menaxhimit*
Financë Kontabilitet *Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit*

Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, secila prej njësive bazë ka në përbërje të saj të paktën 7 pedagogë efektiv. Gjithsej FE ka **21 staf akademik efektiv(PAE)** dhe **16 staf akademik me kontratë.(PAK)**

Kualifikimi i stafit akademik efektiv (PAE) i këtij fakulteti është:

1 Prof.Dr., 1 Prof.Asoc.Dr., 9 Dr, dhe 4 Dr.Kand., dhe 6 Msc.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Struktura akademike e Fakultetit jepet si më poshtë:

Departamenti	Përbërja
Departamenti i Menaxhimit	7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 3 “Doktor”, 2 Dr.Kand., 2 Master Shkencor; si edhe 5 pedagogë me kontratë (PAK)
Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.Asoc.Dr.,3 “Doktor”, 1 Dr.Kand, 1 Master Shkencor; si edhe 5 pedagogë me kontratë (PAK)
Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës	7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 3 “Doktor”, 1 Dr.Kand., dhe 3 Master Shkencor; si edhe 6 pedagogë me kontratë (PAK)

Si struktura dhe personeli drejtues i Fakultetit të Ekonomisë janë, **Organe drejtuese:** Dekanati dhe **Autoritetet drejtuese:** Dekani dhe Përgjegjësi i njësisë bazë.

Në mënyrë më të detajuar të dhënat lidhur me listën emërore të stafit të shpërndarë sipas të 3 departamenteve jepen në **Tabelën 1 në Aneksë.**

Në funksionet e saj FE mbështetet dhe bashkëpunon me njësitë ndihmëse dhe administrative të KUB, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Njësitë ndihmëse të KUB si: Zyra e Marrëdhënieve me jashtë; Zyra e Marrëdhënieve me publikun; Zyra e Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC);
- Sekretariatë mësimore; Laboratori i informatikës; Biblioteka; Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e kurrikulave;
- Njësitë administrative të KUB: Zyra e Administratës, Burimeve njerëzore dhe arkivit; Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar dhe Sektori mbështetës

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

GVJ analizoi të dhënat për stafin e njësisive bazë, që janë përgjegjëse për programin e studimit Bsc. në “Ekonomi” me profile, mbështetur mbi të dhënat e siguruar në RVB dhe gjatë vizitës në institucion, gjatë të cilës nuk u vunë re ndryshime në informacione të përcjellë nga RVB.

Departamentet përgjegjëse për këtë program studimi janë departamentet e fakultetit të ekonomisë sipas profileve konkretisht:

Banka dhe Institucione Financiare **Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit**

Administrim Biznesi **Departamenti i Menaxhimit**

Financë Kontabilitet **Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit**

Në vijim paraqiten të dhënat sasiore dhe cilësore për stafin akademik të departamenteve përgjegjëse për programin e studimit bachelor në “Ekonomi” me profile, për vitin akademik 2017-2018.

Departamenti i Menaxhimit: 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 3 “Doktor”, 2 Dr.Kand., 2 Master Shkencor; si edhe 5 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët 2 Prof.Dr, 1 Prof.As, 1 Dr Kand dhe 1 Msc.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit: 7 pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët: 1 Prof. Dr., 1 Prof.Asoc.Dr.,3 “Doktor”, 1 Dr.Kand, 1 Master Shkencor; si edhe 5 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët 3 Prof.Dr, 1 Prof.As dhe 1 Dr.

Në mënyrë më të detajuar të dhënat lidhur me listën emërore të stafit, titujt dhe gradat e tyre, vendin parësor të punës (për PAK), jepen në Tabelën 2 në Aneks.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standartet e kësaj fushe janë pëmbushur.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Stafi i Kolegjit Universitar "I Biznesit" përbëhet nga: Personeli akademik (efektiv dhe me kontratë) dhe Personeli administrativ.

Sipas RVB, stafi akademik kategorizohet në:

- Rektori
- Dekanët e dy fakulteteve (Fakulteti i Ekonomisë/FE dhe i Drejtësisë/FD)
- Drejtori i kolegjit të studimeve të larta profesionale/KSLP me dy departamente
- Përgjegjësat e departamenteve (3 departamente FD, 3 departamente FE dhe 2 departamente KLSP)
- Stafi akademik në departamente (me nga 7 pedagog efektiv çdo departament)

Personeli administrativ kategorizohet në:

- Administratori
- Sekretaria Mësimore
- Zyra e Financës
- Biblioteka
- Sektori mbështetës
- Punonjëse sanitare

Personeli akademik, në KUB sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet sipas kategorive, të përcaktuara në ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", profesorë, lektorë dhe asistent lektorë. FunkSIONET kryesore të personelit akademik janë veprimtaria mësimore, konsultim për studentët, kërkim shkencor, kontribut për institucionin. Ngarkesa për personelin akademik është në përputhje të plotë me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë *Gjatë viztës në institucion GVJ konstatoi se stafi i brëndshëm akademik i KUB është i angazhuar në shumë funksione. Kjo gjë mund të rëndojë pak punën e tyre të përditshme dhe GVJ, sygjeron një lehtësim të stafit nga punët e tjera administrative.*

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **16 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 11 janë më tituj/grada, dhe **8 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 7 janë me tituj/grada, pra raporti PAE/PAK është 67% / 33%.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Të dhënat lidhur me stafin Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), si dhe titujt/gradat/kualifikimet e tyre, për stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi jepen në **Tabelën 3 në Aneksë.**

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Institucioni ka paraqitur në dosjen e vetvlerësimit tabelat me stafin e angazhuar në programin e studimit, që nga viti akademik 2012-2013, konkretisht:

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **16 personel akademi kefektiv(PAE)**, nga ku 11 janë më tituj/grada, dhe **8 personel akademik me kontratë(PAK)** nga ku 7 janë me tituj/grada. Pra **67% PAE dhe 33%PAK**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **17 personel akademik efektiv(PAE)**, nga ku 9 janë më tituj/grada, dhe **6 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 5 janë me tituj/grada. Pra **74% PAE dhe 26%PAK**.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **18 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 8 janë më tituj/grada, dhe **6 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 4 janë me tituj/grada. Pra **75% PAE dhe 25%PAK**.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **14 personel akademi kefektiv (PAE)**, nga ku 7 janë më tituj/grada, dhe **7 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 6 janë me tituj/grada. Pra **67% PAE dhe 33%PAK**.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **8 personel akademikefektiv (PAE)**, nga ku 2 janë më tituj/grada, dhe **22 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 11 janë me tituj/grada. Pra **27% PAE dhe 73%PAK**.

Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **6 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 2 janë më tituj/grada, dhe **24 personel akademik me kontratë (PAK)** nga ku 10 janë me tituj/grada. Pra **20% PAE dhe 80%PAK**.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Të dhënat sipas moshës së stafit, PAE dhe PAK, jepen në **Tabelën 5në Anekse**.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion, GVJ realizoi edhe një vizitë me zyrën e personelit. Aty u pa nga afër nuna që bënte kjo zyrë për rekrutimet e reja në bashkëpunim të ngushtë me departamentet. Kontrata e punës për stafin përcakton edhe modalitetet lidhur me vlerësimin vjetor të punës dhe përmbushjen e detyrave. Kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhëniet juridike të punës trajtohen sipas legjislacionit në fuqi. Modeli i kontratës së punës, kushtet e kriteret për personelin akademik propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë nuk mund të punësohet njëkohësisht si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, por mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e rektorit. (kjo në përputhje me aktet nënligjore në fuqi) Stafi akademik si edhe ai administrativ ishte i qartë lidhur me të drejtat dhe detyrimet që ka.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Secili nga të dy Fakultetet e KUB, ka nga një sekretare që mbulon marëdhëniet me studentët që nga momenti i regjistrimit fillestar deri në përfundim të të gjithë procesit të studimeve. Gjithashtu ato janë përgjegjëse edhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor, ndjekjen e orarave të zhvillimit të mësimit, regjistrat e mësimit.

GVJ konstaton se KUB ka nevojë për rritje të numrit të stafit ndihmës për të ndihmuar mbarëvajtjen dhe rakordimin në procesin mësimor. Kjo do të lehtësonte paksa edhe situatën e rendesës së stafit akademik me detyra administrative.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimin të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	GVJ mbështetur mbi informacionin e siguar në takimet me drejtues të institucionit dhe me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, konstaton se KUB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit Bachelor në “Ekonomi “me profile ndër vite ka qenë: në vitin 2012-2013 ka qënë 6 PAE ndaj 24 PAK; në vitin 2013-2014 ka qënë 8 PAE ndaj 22 PAK; në vitin 2014-2015 ka qënë 14 PAE ndaj 7 PAK; në vitin 2015-2016 ka qënë 18 PAE ndaj 6 PAK; në vitin 2016-2017 ka qënë 17 PAE ndaj 6 PAK;
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimin të personelit;	GVJ konsaton një përmirësim të dukshëm të raportit PAE/PAK në vitet e fundit. Referuar informacionit të siguar gjatë vizitës në institucion dhe RVB, titullarët e moduleve të programit të studimit “Bachelor në
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të përfundimeve për punë, etj.	“Ekonomi” me profile në a) Administrim Biznesi, b) Financë Kontabilitet dhe c) Banka dhe Inst. Financiare, janë personel akademik efektivë (me kohë të plotë) dhe personel akademik me kontratë. Në mbulimin e programit për profilin “Financë Kontabilitet”rezulton se 80.15 % mbulohet nga PAE, për profilin “Administrim Biznesi”rezulton se 76.98 % mbulohet nga PAE, dhe për profilin “Banka dhe institucione Financiare” rezulton se 80.15 %, mbulohet

	<p>nga PAE.</p> <p>GVJ konstaton se KUB ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Gjatë vizitës në institucion GVJ identifikoi praktika të ndryshme të vlerësimit të personelit, si vlerësimi nga studentët, vlerësimi nga drejtuesit dhe vetëvlerësimi. Forma të tilla vlerësimi konstatohen të depozituara në dosjet personale te stafit, pranë burimeve njerëzore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe inspektimit të praktikave të rekrutimit, GVJ konstatoi se institucioni, disponon një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve ne web-in, për vende vakante, etj. Dokumentacioni lidhur me procesin e rekrutimit dhe seleksionimit (komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë, dosjeve të aplikantëve) depozitohet dhe mbahet në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>
--	--

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>KUB, disponon një bazë të dhënash të plotë dhe që azhurnohet vazhdimisht në lidhje me stafin akademik të përfshirë në programin bachelor në Ekonomi me profile. Gjatë vizitës në IAL, GVJ shqyrtoi në mënyrë rastësore disa dosje të stafit dhe kontatoi se ato janë të plota në të gjithë elementët e tyre.</p> <p>KUB, disponon për çdo semestër listën e stafit akademik dhe mbështetës, që do të angazhohet në këtë program.</p> <p>KUB, ka të përcaktuara kriteret për rekrutimin e stafit, kriteret këto që publikohen në mediat e shkruara apo në faqen zyrtare e institucionit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe shperndarjen e lëndëve sipas stafit akademik, ukonstatua se titullarë të lëndëve/moduleve për programin e studimit, janë personel akademik që kanë së paku gradën shkencore DOKTOR .</p>
---	--

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p>	<p>KUB dhe Fakulteti i Ekonomisë ka angazhuar me kohë të plotë, personel ndihmës mësimor – shkencor, të kualifikuar, për realizimin optimal të programit të studimit bachelor në Ekonomi me profile. Institucioni deklaroi se siguron personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, në bazë të fushës së interesit që ka studenti.</p>
---	--

<p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për realizimin e praktikave të studentëve. Në këtë drejtim bashkëpunimi me studiot ligjore është shumë produktiv.</p> <p>(Dokument mbështetës, Mareveshjet më partnerë)</p> <p>Grupet mësimore në praktikat pranë bizneseve apo institucioneve të tjera kanë një numër të vogëlstudentësh, duke rritur ndjeshëm efektivitetin e praktikës dhe efijencën e orës mësimore.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Nga vizitat e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi që stafi i KUB realizon vazhdimisht trajnime të ndryshme, të mbështetura nga vetë institucioni.</p> <p>KUB promovon personelin efektiv dhe atë me kontratë duke i mbështetur ato me pjesëmarrje të tyre në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare. Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit u dhanë dëshmi të ndryshme për suportin që KUB jep për organizimin e trajnimeve, seminareve, leksioneve me specialishtë të ftuar të fushës, u siguron leje të paguar per mbrojtjen e titujve e gradave shkencore, etj.</p> <p>KUB disponon një bazë të plotë të dhënash lidhur me organizimin e programit të studimeve në faqen e saj web në sistemin e menaxhimit të të dhënave AMS të ASCAL.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>KUB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.</p> <p>KUB promovon personelin efektiv dhe atë me kontratë duke i mbështetur ato me pjesëmarrje të tyre në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë nuk ka personel ndihmës mësimor-shkencor.</p> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur</p>	
<p><u>Rekomandim.</u></p> <p><i>Të shtohet numri i stafit administrativ, në mënyrë që të lehtësohet ngarkesa e stafit akademik me detyra administrative.</i></p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Sa i përket infrastrukturës, Institucioni i Arsimit të Lartë Jopublik KUB e ushtron aktivitetin e tij mësimdhënës në Tiranë, në adresën: Rr. "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë Tiranë, në një ambient të dedikuar posaçërisht për ushtrimin e aktivitetit nga ky institucion. KUB ushtron aktivitetin në një ndërtesë prej 4-katesh, shoqëruar me një ndërtesënjë katëshe ngjitur në krah të saj, ajo përballë saj, ambjenti i zyrave të financës, si dhe ambjenti tjetër çlodhës dhe rekreativ për studentet, si dhe parkimi i automjeteve arrijnë në 3860 m². (Planimetria e KUB, Dok. 28 te dosja e vetevlerësimit) I gjithë objekti, tek i cili rezulton të jenë kryer investime edhe nga vetë KUB, është marrë me qera për një periudhë 12 vjeçare, bazuar kjo në kontratën e qerasëme Nr. 5153 Rep. dhe Nr. 1711 Kol., datë 11.09.2014, me afat vlefshmërie deri në vitin 2026.

Kolegji Universitar "I Biznesit" ka siguruar ambiente të mjaftueshme dhe ka krijuar kushte pune të mira për personelin akademik. Aktualisht mjediset për stafin e KUB janë të organizuara në përputhje me misionin dhe përgjegjësitë e çdo strukture organizative. (Tabela 6,në Aneksë)

Gjithashtu, duke qënë se KUB nuk ka ambiente për çdo njësi kryesore më vete dhe aq më shumë për çdo program studimi, ambientet e përbashkëta të tij janë në godinën qendrore duke siguruar kushte shumë normale për njëveprimtari akademike shumë cilësore. Ato janë të pajisura dhe të organizuara në mënyrë të tillë që të përmbushin kërkesat, për të gjitha nevojat bazë të studenteve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Gjithë mjedisi ku zhvillohet veprimtaria mësimdhënëse, përdoret ekskluzivisht nga Kolegji Universitar "I Biznesit". Ambientet e godinës të japin idenë e një ndërtese moderne dhe funksionale. Ndërtesa, në funksion të veprimtarisë mësimore, është strukturuar në disa ambiente, që gjatë vizitës rezultuan si vijon:

- a. Auditorë/salla mësimi të pajisura me videoprojektor dhe laptop;
- b. Ambiente për personelin akademik dhe administrativ;
- c. Ambient i dedikuar për bibliotekën;
- d. Ambiente laboratorësh;
- e. Ambiente internet – kafe;
- f. Ambiente për shërbimet Financiare dhe të praktikës profesionale për studentet;
- g. Arkivë, magazina;
- h. Ambiente teknike dhe pajisje;
- i. Shkallë emergjence;
- i. Oborr hulishte;
- k. Ambient parkimi jashtë ambienteve të godinës.

Ambientet/sallat e mësimdhënies, janë të pajisura me tabela, videoprojektor, tavolina, karrige, kompjutera, në funksion të zhvillimit të orës mësimore, duke krijuar lehtësi për zbatimin e programeve mësimore. Vendimi nr. 418, datë 10.05.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionëve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre" dhe Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë", përcaktojnë kriteret të organizimit dhe infrastrukturës që duhet të përmbushë një institucion i tillë.

Godina ku ushtron aktivitetin Kolegji Universitar "I Biznesit" rezulton të përmbushë këto kritere të përcaktuara në aktet nënligjore.

Mjediset për stafin

Të dhënat lidhur më stafin e KUB, në terminologji të sipërfaqjes së disponueshme janë të vendosura në (Tabelën 6 në Anekse). Kjo gjë u vërtetua edhe nga vizita e GVJ në IAL.

Norma faktike në m² për një student në bazë të sipërfaqes gjithsej që ka në dispozicion KUB, rezulton 7.018 m²/student ose 2,8 herë më shumë nga sa është përcaktuar në VKM.Nr.418, që është 2.5m²/student. Sipërfaqja gjithsej e ambienteve në dispozicion të Kolegjit Universitar "I Biznesit", dhe që përbëhet nga ambientet në godinën qendrore dhe jashtë godinës qendrore, së bashku janë 3860 m².

Studimet në programet e cilkit të parë "Bachelor" zhvillojnë procesin mësimor nga ora 8:30 – 14:30, me numer maksimal studentësh që studiojnë paradite rreth 550 student. Norma faktike e sipërfaqes për një student është 7.018 m² (3860m²/550 student).

Studimet, "Master i Shkencave", "Master Profesional" dhe një pjesë e mirë nga studentët e Ciklit Bachelor, studjojnë pasdite, për shkak se janë në marrdhenie pune, zhvillojnë procesin mësimor nga ora 15:30 – 20:30, në të njëjtat ambiente. Numri maksimal i studentëve që studiojnë pasdite është rreth 550 student. Norma faktike e sipërfaqes për një student është 7.018 m² (3860m²/550 student), pra standardet tejkalohen.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p>	<p>Bazuar në vizitën dhe takimet me studentët dhe stafin GVJ konkludon se studentët pajisen me literaturën bazë për cdo modul nga pedagogët e lëndës. Ndërkohë që KUB ka të gjithë kapacitetet e duhura për të ofruar literaturën shtesë për këtë program mësimor.</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me fondin fizik përkatës si për literaturën e nevojshme ashtu edhe atë ndihmëse. Vec kësaj nga konstatimi dhe intervista rezultoi se studentët janë të orientuar në gjetjen e adresave online të bibliotekave elektronike.</p>
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p>	<p>Biblioteka disponon një koleksion prej mbi 5000 ekzemplarësh, që përbëhen nga libra shqip dhe në gjuhë të huaj, në funksion të sigurimit të literaturës bazë dhe literaturës së rekomanduar në programet e studimit të fushës së drejtësisë dhe ekonomisë, që ofron institucioni. Përveç librave, në sallën e bibliotekës ndodhen 4 kompjuter (lap top) për kërkime të ndryshme online.</p>
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p>	<p>Krahas librave KUB ofron dhe mundësinë e kërkimit të literaturës online nga biblioteka të njohura me të cilat ka realizuar abonime siç është "Questia Library", në të cilën studentët kanë mundësi të shfletojnë mbi 83.000 libra dhe 10 milion artukuj.</p>
<p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	

	<p>Departamentet dhe stafi akademik, periodikisht pasurojnë me botimet e tyre bibliotekën. Gjithashtu institucioni bën blerje të vazhdueshme të literaturës duke u bazuar në nevojat e stafit të tij.</p> <p>Synimi kryesor i KUB mbetet pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës si edhe garantimi i aksesit të plotë për studentët dhe stafin akademik në më tepër librari elektronike shkencore të fushës ekonomike dhe juridike. Biblioteka ka një orar si për studimet e para dites dhe ato të pasdites.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>KUB/Fakulteti i Drejtësisë, ndonëse nuk ka salla të ndara ndërmjet dy fakulteteve, mjediset janë plotësisht të bollshme për kapacitetin që kanë. Aktualisht është në prag të funksionimit edhe një mjedis i ri me hapsira për më shumë se 1000 studentë.</p> <p>Klasat dhe sallat për leksione e seminare, por dhe salla e internetit, biblioteka dhe hollu i brendshëm, ashtu dhe bar kafeja janë të pajisur me kompjuter e sinjal interneti për 24 orë.</p> <p>KUB, ofron për studentet Laboratorin e informatikës me 26 komplete kompjuterash (PC), të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop.</p> <p>Në to janë instaluar edhe Programe /Softë aplikative të Financës dhe Kontabilitetit (Financa 5, Alfa etj).</p> <p>FE ka siguruar një rrjet të gjerë marrëveshesh dypalëshe të nënshkruara me kompani e institucione të ndryshme, ku KUB dërgon pranë tyre studentë për të kryer praktikën mësimore dhe profesionale.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga analiza e hapsirave të raportuara dhe të verifikuara në vend, rezulton se KUB/FE në varësi të studentëve që ka në programet e tij i përmbush plotësisht standartet për të ofruar hapsirat e mjediset e duhura në funksion të procesit mësimor e kërkimor shkencor.

Stafi akademik ka kushte të mira pune dhe si të tilla plotësojnë të gjithë nevojat e tyre për një proces sa më cilësor.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur**

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet financiare të Kolegjit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura më poshtë. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang Kolegji ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga eksperte të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kerkuara.

Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studenteve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohet për qirane e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirembajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.). Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamen, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të leshuar nga QKB.

Tregues të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit

Të dhënat lidhur me financimet e ndryshme për 6 vitet e fundit japën në **Tabelën 7 në Anekse.**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje, për 2017):

• Grantet për kërkim	0
• Konsulencat, shërbimet	0
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	95.1
• Sponsorizimet	0
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0.5
• Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj	0
• Të ardhura të tjera nga veprimtaria	0.4
• Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj)	4

Shpenzimet për studentët që ndjekin programin e studimit, kosto e studimit për vit akademik

Kosto për student ka ardhur në rritje nga viti 2012-2013 deri në vitin 2017-2018. Kjo rritje shkon deri në +22%.

Ndërkohe që lidhur me shpenzimet për student, pjesa më e madhe e shpenzimeve, mbi 60% shkon për koston e punës. Kjo shifër është në këto nivele që prej vitit 2012 e deri më sot.

Kapacitetet menaxhuese financiare

Sic u përmend edhe më lart, burimet financiare sigurohen kryesisht nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Ka edhe investitorë qëfinancojnë për situatat e krijuara për diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve, apo nevojave për të kryer investime. Burime të dyta tepër modeste janë ato që realizohen nga trajnimet dhe kualifikimet e vijueshme të profesionisteve, nga rreth 500 mijë lek cdo vit dhe vitin e kaluar realizuan rreth 2.2 milion lekë nga një Projekt si Nenkontraktor APB me Kompaninë "KAZAZI CINSULTING" SHPK, për një Studim Rajonal lidhur me "Kontrabanden e duhaneve dhe Cigareve me Shtetet e rajonit dhe nevoja e përmirësimeve të Politikave Fiskale për eliminimin e saj", për të cilën KUB është vlerësuar shumë mire me produktin që ajo realizoi. Në këtë kuader nevojitet të nenvizohet se KUB e ka strukturuar hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të IAL duke e fokusuar në detajimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel të Departamenteve, duke u mbështetur tek numri i studenteve dhe stafi i sejcilit prej tyre.

Institucioni auditohet nga ekspert kontabël i autorizuar i huaj, i cili përgatit Raportin e Auditimit përkatës që certifikon cilësinë e informacioneve të pasqyrave financiare të Kolegjii Universitar të Biznesit. Kopja e Raportit disponohet nga institucioni dhe njëkohësisht depozitohet pranë QKR-së.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Nga verifikimet e realizuara në vend, konstatoam se respektohen të gjithë kërkesat ligjore.
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	KUB kryen rregullisht auditim të brendshëm e të jashtëm, gjë e cila tregohet në dokumentet shoqërues si të raportit por edhe të atyre që u konstatoan në vend.
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	I gjithë stafi akademik është i mireinformuar për pagesat dhe kontributet personale që derdhen për to.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;	KUB, rregullisht kalon në Senat Raportin financiar vjetor dhe përcakton krieteret përkatëse të përdorimit të buxhetit. Në këtë mënyrë vihet re se edhe të ardhurat financiare kanë qenë në rritje dhe se infrastruktura ka ardhur gjithnjë e në përmirësim. Dokumentacioni mbi përdorimin e buxhetit është tërësisht transparent dhe i aksesueshem prej cilitdo.
Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;	
Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe	

gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Konkluzionet e vlerësimit:

Institucioni menaxhon drejt të ardhurat financiare, i dokumenton si të ardhurat dhe shpenzimet duke qenë transparent për këdo në lidhje me të ardhurat, baza e të cilave janë tarifatat e studimit që paguhen nga studentët.

Në institucion por edhe në tabelat bashkëlidhur janë të detajuara të ardhurat dhe kostoja e cdo programi studimi dhe vetë kosto e studimit për studentet në vite. Nga ajo që verifikuam në vend por edhe nga kontaktet me studentet e stafin administrativ vërejtëm se ka një qartësi dhe siguri në mënyrën se si vilen të ardhurat dhe si shpenzohen ato.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur.**

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Nga kontakti i parë që morem me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, por edhe në konstatimet e bëra direkt në institucion u vu re se parimi i kontrollit të cilësisë së brendshme të të gjithë procesit mësimor është i institucionalizuar plotësisht dhe se aktiviteti i kësaj njësie ka filluar që me krijimin e institucionit. Në institucion vumë re se anëtarët e NJSBC, janë staf akademik me eksperiencë, me integritet dhe përfaqësues nga i gjithë personeli akademik, administrativ dhe studentor. Rezulton se misioni dhe detyrimet e NJSBC janë më të gjëra dhe se veprimtaria e Zyrës është e kufizuar. Gjykohet se në përbërje të njësisë të Sigurimit të Cilësisë duhet të dominojnë stafi me eksperiencë më të gjatë pune.

NJSBC, është e pavarur dhe aktiviteti i saj përfshin të gjithë procesin mësimor e kërkimor shkencor. Teknikat e përdorura si intervista, opinione, kontrolle në orën e mësimi, vlerësimet e veprimtarisë shkencore etj, kanë qenë objekt i raportit që kjo njësi ka mbajtur në Senat.

Këto rezultate kanë vënë në lëvizje strukturat përkatëse për të përmirësuar marrëdhëniet dhe për të vlerësuar ecurinë e mëtejshme të procesit mësimor por edhe vetë personalitetin e stafit akademik.

Mbështetur në RVB, aktiviteti i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbështetet nga ligji Nr.80/2015 (Neni 103); rregullohet nga Statuti i IAL KUB (Neni 82), Rregullorja e KUB (Neni 108, 109) si dhe nga Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Mekanizmi bazë me të cilin NJSBC realizon misionin dhe objektivat është vlerësimi i brendshëm i cilësisë, që është një proces i pandërprerë, me qëllim kryesor përmirësimin e kulturës së cilësisë brenda IAL-së.

NJSBC në këtë proces periodik mbikëqyr, analizon dhe rekomandon rregullimet e nevojshme në drejtimet kryesore, sipas përcaktimeve të Standardeve të cilësisë së Arsimit të Lartë. Në raportin e

vetvlerësimit, listohen detyrat dhe funksionet e NJBSC, të cilat janë të sanksionuara në dokumentat bazë të Institucionit.

Rezulton se misioni dhe detyrimet e NJBSC janë më të gjëra dhe se veprimtaria e Zyrës është e kufizuar. Gjykohet se në përbërje të njësisë të Sigurimit të cilësisë duhet të dominojnë stafi me eksperiencë më të gjatë pune.

Anëtarët e Njësisë në takimin e zhvilluar me ta, pohuan se: Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë e KUB-it çdo fund viti akademik përgatit një raport vjetor në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë së veprimtarisë së saj. (<http://kub.edu.al/sq/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/>) Procesi i vlerësimit të brendshëm përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve, rezultatet e kontroleve periodike të realizuara nga anëtarët e NJSBC-së (syllabus lëndë, procesverbal, fletë dorëzimi provimi, format dorëzimi provimi, tezë origjinale, etj). Anëtarët e NJSBC janë të listuar në Tabelën 8 në Aneksë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët 2 herë në vit
- Sa studentë janë anketuar 85% e kursit
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Në anketimet, studentët kanë shprehur shqetësimet lidhur me:

- penalizimin për shkak të mungesave dhe të mosndjekjes së studentëve të leksioneve e seminareve,
- hapësirave të kufizuara për studim,
- mungesa e shërbimit të sekretarisë online,
- mospërfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore,
- numrin e kufizuar të titujve të librave në gjuhën shqipe,

Këto shqetësime janë relatuar nga NJSBC dhe janë trajtuar edhe nga Rektorati.

NJSBC ka zhvilluar periodikisht anketime e kontrole për çdo vit akademik. Më konkretisht ne vumë re se kjo njësi është gjithnjë në aktivitet, pasi edhe në kohën që GVJ ishte për vizitë në këtë Kolegj, vume re se ata interesoheshin edhe për mënyrën e regjistrimit të studentëve të rinj dhe komunikimin e stafit me kandidatët që kërkonin të studionin në këtë institucion.


Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Cilësia e stafit akademik ka qenë objekt kryesor i veprimtarisë akademike të KUB, vlerësuar kjo edhe nga treguesit e matshëm që nga viti i parë i akreditimit deri më sot. KUB ka ndjekur një politikë vetëzhvilluese në thithjen e stafit akademik me cilësor. Fakt është se në ditët e vizitave që ushtruam si ekip, vumë re një pjesëmarrje të gjerë të një stafi cilësor dhe shumë të predispozuar për procesin mësimor. Përzgjedhja dhe procedurat përkatëse ishin shumë transparente dhe me nivel cilësor për tu vlersuar shumë pozitivisht. Të gjithë njësitë përbërese të njësisë kryesore në nivel institucioni dhe fakulteti funksiononin qartësisht dhe disponoheshin rregullorë e standarde të qarta publike për të gjithë procedurat.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Sipas konstatimeve të bera nga GVJ, krahasuar për periudhën nga akreditimi i parë të vitit 2012, deri në akreditimin periodik, të tetorit 2018, vihet re një përmirësim i dukshëm i procesit akademik, në të cilin përfshihet edhe stafi akademik. Të dhënat e matshme mund të analizohen në pasqyrat statistikore të paraqitura në këto raporte dhe të verifikuara në institucion. Institucioni ka kryer edhe vlerësimin periodik institucional në vitin 2017 duke marrë akreditim për katër vite akademike. E gjitha kjo tregon se institucioni ka ardhur duke i përmbushur si detyrimet dhe zhvilluar treguesit e standardeve përkatëse të procesit të arsimimit. Për të siguruar vlerësime sa më të besueshme, të pavarura dhe profesionale, lidhur me problematikat dhe përmirësimin e punës, në vitin 2015 KUB realizoi një studim me Kompaninë "Tirana Business Research Center" (TRBC), e cila ka përgatitur dy raporte vlerësimi, mbështetur në dy pyetësorë: një për plotësim nga studentët, tjetri nga pedagogët. Gjatë takimeve në institucion konstatuam se rezultatet e këtij studimi ishin të ngjashme me ato të vetë IAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>Fakulteti i Ekonomisë e ka të institucionalizuar procesin e vlerësimit, nëpërmjet rregulloreve përkatëse por edhe kërkesave që shoqërojnë programin në syllabuset e çdo lënde/modul.</p> <p>Ky informacion është pjesë e vlerësimit institucional, në raportin e të cilit është pasqyruar mënyra e vlerësimit dhe metodologjia e tij. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në raportin vjetor por edhe në faqen e internetit.</p> <p>Metodat e përdorura janë të natyrave të ndryshme, sondazhe, pyetësor, intervista, kontrolle të procesit mësimor e tj.</p> <p>Metodat e vlerësimit shoqërohen me teste, pikë, notë, vëzhgime në distancë, inspektime, apo edhe direkt dëgjimin e seancave të leksioneve, seminareve dhe provimeve.</p> <p>Të gjitha këto në i konstatuam direkt në institucion nëpërmjet kontrolleve të dokumentacioneve por edhe pyetjeve të studentëve e stafit akademik, vec takimit me NJSBC.</p>
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat); 	

<p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj.</p>	
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni i është nënshtruar vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit periodik në vitin 2017 dhe me vendim Nr.100, date 10.01.2017 nga BA, KUB e ka marrë akreditimin për një afat 4 vjeçar.</p> <p>Institucioni ka NJSCB, e cila periodikisht bën vlerësimin e cilësisë së brendshme në institucion duke e shoqëruar për cdo vit akademik me një raport të detajuar për aktivitetin e institucionit në Senatën Akademik.</p> <p>Ne konstatojmë se problemet që ngre njesia e NJSBC shërbejnë si udhëzues për përmirësimin e veprimtarisë akademike si dhe për aplikimin e masave administrative për rastet e shkeljeve që çenojnë etikën e institucionit dhe të procesit mësimor.</p> <p>Politikat e institucionit për ndërgjegjësimin e stafit dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të materializuara në strategjinë e zhvillimit të KUB, e cila është e publikuar dhe zotërohet nga stafi akademik.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Sa më sipër, ne konstatojmë se standartet për sigurimin e cilësisë së brendshme të procesit të arsimimit në këtë instituicion përmbushem plotësisht.</p> <p>Siguria në procesin e menaxhimit të cilësisë së brendshme shprehet në bashkepunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet NJSBC dhe të gjithë strukturave akademike, duke qenë konkret në atë që bëhet dhe planifikimin e vazhdueshëm për të siguruar reflektimin e masave që kjo njësi nxjerr në veprimtarinë akademike.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar procesin e kontrollit të brendshëm të cilësisë periodikisht duke mbajtur nivelin e procesit mësimor në kushtet optimale të kërkesave e standardeve përkatëse.</p> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se standardet e kësaj fushe janë përmbushur.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi”, me profile: a. Banka dhe Institucionet Financiare, b. Finance Kontabilitet, c. Administrim Biznesi, ofrohet krahas programeve të tjera të studimit që realizon Fakulteti i Ekonomise (FE), në Kolegji Universitar “I Biznesit”. Ai është aktivizuar në vitin akademik 2012 – 2013.

Programi i studimit ka si objektiv kryesor të përgatise ekonomiste të profilit financiar dhe bankar, me njohuri bashkekohore, të aftë të punojne ne kompani apo ne institucione me njohuri të mjaftueshme për t’u adaptuar edhe si menaxhere për bizneset ne pergjithesi; specialiste të larte të sektorit të finances, menaxhere dhe konsulente ne kete sektor, nepermjet ofrimit të njohurive dhe shprehive të nevojshme teknike dhe manaxheriale për të krijuar nje karriere të suksesshme ne sektorin e biznesit apo ne sektore të tjere të administrates dhe ekonomise; pra t’i pergjigjet nevojave të tregut të punes.

Disiplinat që ofrohen janë në fushat ekonomike, të kontabilitetit, juridike, financiare, manaxheriale, matematike e statistike, por edhe informatike, gjuhe e huaj dhe praktike profesionale.

Programi i studimit ka për qëllim kompletimin e njohurive dhe shprehive të transmetuara studentëve dhe harmonizimin e tyre, për të mundur përgatitjen e studenteve të ciklit të parë për tregun e punës sipas tre profileve, por edhe për të krijuar mundësi për vazhdimin e metejshëm të studimit në programe të të njëjtit lloj apo në programe të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe avancimin e studimeve në nivelin Master i Shkencave apo Master Profesional. Në këtë mënyrë, mundësohet më mirë mobiliteti i studentëve dhe stafëve akademike.

Permbajtja e programit:

Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile është program studimi i ciklit të parë (Bachelor). Ai është i organizuar në tre vite akademike me nga 60 ECTS në vit, për një total prej 180 ECTS.. Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit janë të organizuara në 6 kategori, dhe kanë këtë strukturë si më poshtë:

1. disiplina të formimit bazë	(36 ECTS) = 20%
2. disiplina të formimit karakterizues	(90 ECTS) = 50 %
3. disiplina të ngjashme ose integruese	(18 ECTS) = 10 %
4. disiplina me zgjedhje	(14 ECTS) = 7 %
5. gjuhe e huaj, informatike, praktike	(17 ECTS) = 9 %
6. Punimi i diplomës	(5ECTS)= 4 %

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit është organizuar në gjashtë semestra, për tre vite. Në të përfshihen lëndët, modulet, kreditet dhe orët për çdo kredit, në auditor dhe jashtë auditorit. Po kështu në program janë përcaktuar edhe materialet mbështetëse dhe literatura për secilën lëndë.

Numri i krediteve sipas semestrave është si në **Tabelën 9 në Anekse**.

Shpërndarja e lëndëve sipas viteve dhe semestrave, është bërë në përputhje me një filozofi të të mësuarit që kalon nga formimi i përgjithshëm te formimi bazë profesional dhe formimi i veçantë profesional, të harmonizuara me disiplinat mbështetëse.

Viti akademik është organizuar në semestra dhe çdo semestër është konceptuar dhe organizuar nga 15 javë mësimore në auditor. Oraret dhe programi ekzekutohen nëpërmjet orareve të ndërtuara sipas kësaj shpërndarjeje:

- Viti akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- Viti akademik ka dy semestra
- Një kredit, është llogaritur me 25 orë mësimore në auditor dhe punë e pavarur e studentit,
- Ora mësimore është llogaritur me 50 minuta

Programi i studimit dhe kreditet janë të transferueshme dhe Kolegji pranon studentë që vijnë nga programe të njëjta të universiteteve të tjera, si dhe studentët e këtij programi mund të transferohen në fakultete të tjera të shkollave të tjera të larta.

Në mënyrë më të detajuar, shpërndarja e lëndëve sipas viteve akademike, orëve në auditor dhe numrit të krediteve, prezantohen në **Tabelën 10 në Anekse**.

Nga njeri profil në tjetrin, në vitin e dytë, ndryshon vetëm një lëndë, ndërsa në vitin e tretë të studimeve, vetëm tre ose katër lëndë. Kjo do të thotë që profilet janë shumë afër njeri tjetrit dhe realisht studentet nuk profilizohen në profile të dallueshme mirë njeri nga tjetri.

Dy programet e studimeve të dy profileve, "Finance Kontabilitet" dhe "Bankat dhe institucionet financiare" për të tre vitet janë identike. Ka një ndryshim të paperfillshëm në emertimin e një lëndë, konkretisht "Kontabilitet i Aplikuar/E drejta në sigurime" (në profilin Banka dhe Institucione Financiare) dhe "Kontabilitet i Aplikuar" (në profilin Financë Kontabilitet)

Nëse do të shikojmë në mënyrë krahasimore të tre profilet e studimeve në Bachelor, "Ekonomi" me profile, konkuldojmë:

- Në vitin e parë të studimeve për të tre profilet Banka dhe Institucionet Financiare, Finance Kontabilitet dhe Administrim Biznesi, ka një përputhshmëri modulesh në masëm 100%,
- Në vitin e dytë të studimeve për të tre profilet, ka një përputhshmëri modulesh në masëm 91%, ndërkohë që për dy profile, Banka dhe Institucionet Financiare, Finance Kontabilitet, përputhshmëria është 100%,
- Në vitin e tretë të studimeve për të tre profilet, ka një përputhshmëri modulesh në masëm 50%, ndërkohë që për dy profile, Banka dhe Institucionet Financiare, Finance Kontabilitet, përputhshmëria është 87.5% me të vetmin ndryshim moduli që është përmendur më sipër.

Nisur nga analiza e mësipërme, GVJ, sygjeron që të ketë një diversifikim më të madh të moduleve midis profileve, sidomos midis "Finance Kontabilitet" dhe "Banka dhe institucionet financiare"

Ndryshimet në Planin mësimor, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Lidhur me ndryshimet që kanë ndodhur në kurikulën e këtij programi studimi, GVJ, konstaton se ka patur ndryshime në disa drejtime:

- Ndryshim i numrit të krediteve për module të caktuara. Kjo ka qënë në masën 14%, nga vizitat në IAL u konstatua se ky ndryshim ka ardhur kryesisht si pasojë e ndryshimeve të akteve nënligjore.
- Ndryshime në emrat dhe vetë modulet. Kjo ka qënë në masën 6%.
- Ndryshime në heqje apo shtim modulesh. Kjo ka qënë në masën 3%.

Në formë të detajuar këto ndryshime jepen në **Tabelën 10.1 në Aneksë.**

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Për secilën lëndë ka një syllabus. Në to shpjegohen në detaje, vëllimi i orëve në auditor, dhe jashtë auditorit, ndarë në leksione dhe seminare. Gjithashtu në to shpjegohen: emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, grada dhe titulli që ka pedagogu, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës, niveli i njohurive që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar në përputhje të plotë me udhëzimet dhe standartet e pasqyruara në këtë raport më sipër. Përmbajtja e syllabuseve ofron jo vetëm përmbajtjen e nevojshme në përputhje me misionin e programit të studimit bachelor në “Ekonomi” me profile. Syllabuset parashikojnë një raport të drejtë të orëve të leksionit me seminarët dhe punën individuale e zgjidhjen e detyrave të ndryshme. Për realizimin e qëllimit të tij çdo syllabus është i programuar të realizohet në 14-15 javë dhe me sasinë e krediteve përkatëse, me orë në auditor, orë individuale dhe mënyrën e realizimit të kontrollit dhe të vlerësimit.

GVJ konstaton se përbërja e cdo syllabusi është e qartë dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Ekonomi” me profile, është licencuar me VKM nr. 651, date 14.09.2011, dhe është akredituar për herë të parë me urdhër të MASH nr. 500, datë 18.10.2012.</p> <p>Institucioni është akredituar me emrin Akademia Profesionale e Biznesit me Urdher nr. 557 date 16.11.2012, dhe është riakredituar me VBA Nr. 100 date 10.11.2017, me kohezgjatje 4 vite akademike.</p> <p>Ne baze të Urdherit të MASR nr. 39 date 30.01.2018 "Për miratimin e Statutit të Kolegjit Universitar "I Biznesit", ky institucion funksionon si kolegji.</p>

	<p>Të gjitha programet e ofruara nga FE janë të akredituara.</p> <p>Numri i krediteve që grumbullohet për çdo vit akademik është 60 ECTS dhe për gjithë programin tre vjeçar të studimit është 180 ECTS.</p>
--	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti japin informacion lidhur me programin e studimit Bachelor në “Ekonomi” me profile që javën e parë të pranimit të studentëve.</p> <p>Ata orientohen me: kurrikulen, orarin, kreditet, kalendarin akademik dhe njesite ku ata mund të drejtohen për informacione dhe kërkesa të ndryshme, lidhur me programin e studimit. Studenteve ju jepet informacion i detajuar nga departamenti perkates dhe sekretaria apo pedagogët e lëndëve të posaçme, gjate shpjegimit ne javen orientuese per studentet e vitit të parë.</p> <p>Pjesë e informacionit për studentët është edhe ngarkesa mësimore, orët në auditor, kërkesat për frekuentimin e detyrueshëm, detyrimet gjatë vitit të lëndës, etj.</p> <p>Çdo pedagog në oren e parë te semestrit ju shpjegon studenteve syllabusin e lendes. Nëse studenti kërkon materiale te printuara, departamenti i leshon te printuara syllabuset dhe materiale te tjera te nevojshme, te kerkuara nga studenti.</p> <p>Modulet dhe syllabuset ofrohen si te printuara, ashtu edhe ne rruge elektronike.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimeve Bachelor në “Ekonomi”, me profile: Finance Kontabilitet, Administrim Biznesi dhe Banka dhe institucionet financiare, është ndërtuar sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, me kërkesat për kreditet gjithsej, ndarjen sipas viteve dhe semestrave, numrin e orëve për një kredit, raportin midis orëve në auditor dhe jashtë autorit, raportin midis orëve në disiplinat e formimit të përgjithshëm, si dhe atyre të formimit të përgjithshëm profesional dhe formimit profesional të veçantë, për financën dhe bankat.

Studenti ka aksesin e nevojshëm për të marrë informacionin në formë të shkruar apo online, nga njësia bazë, njësia kryesore apo nga sekretaritet mësimore.

GVJ, sygjeron qe të ketë një diversifikim më të madh të moduleve midis profileve, sidomos midis Finance Kontabilitet dhe Banka dhe institucionet financiare

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur kryesisht.**

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është e organizuar me leksione, seminare, punime në laboratore dhe praktika mësimore. Struktura e ngarkeses totale në auditor për programin bachelor në "Ekonomi", me tre profile të këtyre elementëve, përbëhet si në **Tabelën në 11 Anekse**.

Pedagogët, në fillim të çdo semestri, hartojnë programin e lëndës, ku përfshihen, qëllimet, objektivat, koha e realizimit, kreditet, temat që do trajtohen dhe plani kalendar i zhvillimit të orëve mësimore.

Vlerësimi i studentëve bëhet me nota, me sistemin me dhjetë nota si dhe me gërma sipas këtij rendi:

Pikët	Nota	Vlerësimi me Gërma
95-100	10	A
91-94	10	A-
86-90	9	B+
81-85	9	B
76-80	8	B-
71-75	8	C+
66-70	7	C
61-65	7	C-
56-60	6	D+
51-55	6	D
46-50	5	D-
41-45	5	E
00-40	4	F

Grupi i ekspertëve të jashtëm, ekzamoni me kujdes, rezultatet dhe kalueshmërinë e studentëve, në shkallë programi, fakulteti dhe Kolegji. dhe konstatoi se:

- institucioni analizon kalueshmërinë dhe cilësinë,
- ka luhatje të konsiderueshme të kalueshmërisë midis studentëve të fakulteteve të ndryshme,
- ka luhatje të konsiderueshme të kalueshmërisë dhe notës mesatare, midis studentëve të vitit të parë dhe atyre të viteve të larta, në të njëjtin program,
- gjykojmë që në kalueshmërinë e lartë të studentëve të viteve të larta (viti dytë dhe i tretë bachelor, programi Financë/Bankë), ka ndikuar edhe paqëndrueshmëria e stafit akademik.

Metodat e mësimdhënies janë ndërvepruese, duke vënë në epiqëndër studentin. Kujdes i veçantë tregohet për përmirësimin e teknologjisë së mësimdhënies, për përdorimin e metodave interaktive, përdorimin e informatikës, të internetit dhe të mjeteve të tjera audiovizive. Kontrolli i njohurive realizohet me forma të ndryshme, të ndërthurura dhe të shtrira në kohë, përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Cdo lëndë kontrollohet dhe vlerësohet nëpërmjet dy elementëve kryesore:

- vlerësimi i vazhduar;
- vlerësimi në fund të semestrit, me provimin e lëndës;

Vlerësimi i vazhduar realizohet nga detyrat e kontrollit, nga punimet e kursit, nga kolokiumet, nga pjesmarrja dhe aktivizimi. Format e kontrollit dhe pesha e tyre jepen në **Tabelën 12 në Aneksë**.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë përmbushur**.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimet në programin e studimit Bachelor në "Ekonomi" me profile, prane KUB, në vitin akademik 2017-2018 janë me kuote të paracaktuar. Kolegji ka hartuar kritere pranimi, të cilat janë kompozuar si vijon:

- 30% mesatarja e përgjithshme;
- 30% mesatarja e grup lendeve perkatese;
- 40 % intervista që konsiderohet si elementi kryesor në kriteret e pranimit të studentëve në KUB.

U njihet e drejta për të aplikuar në këtë program studimi shtetasve shqiptarë të pajisur me dokument zyrtar të perfundimit të shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalente sipas kriterëve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).

Të drejtën për të aplikuar për pranimin në ciklin e parë të studimeve e kanë edhe studentët e huaj, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. Studentët që kanë të drejtën të përfitojnë burse studimi (perballimin e pagesës për studime prej kolegjit), apo gjysme burse studimi, e kanë si rregull vetëm studentët apo maturantët që kërkojnë të vijojnë studimet në këtë kolegji dhe që kanë mesatare të përgjithshme mbi 9.5 apo mbi 9, nga dhjetë që është nota maksimale e vlerësimit në sistemin arsimor shqiptar.

Dokumentet që duhen të paraqesin studentët janë:

- Diplome e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave;
- Deftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit;
- Deftese pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011);
- Fotokopja e kartës së identitetit, letër njëfirmimi ose pasaportës;
- 4 fotografi;
- Formulari i aplikimit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.

Studimet e Ciklit të Parë zgjatën, si rregull, gjashtë semestra, tre vite akademike, me nga dy semestra në një vit akademik.

Brenda këtyre semestrave përfshihen si forma mësimore leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat mësimore, specializimet, kualifikimet, kërkimi shkencor dhe angazhime të tjera akademike.

Ecuria e të rregjistruarëve në programin e studimeve Bachelor në Ekonomi sipas 3 profileve, për 6 vitet e fundit, paraqitet në Tabelën 13 në Anekse.

Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë)

Për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë të regjistruar për herë të parë në total 92 studentë përkatësisht sipas profileve:

Financë Bankë	59 studentë
Administrim Biznesi	31 studentë
Banka dhe Institucione Financiare	2 studentë

GVJ, konstaton se për profilin Banka dhe Institucione Financiare, numri i studentëve është shumë i vogël. Kjo gjëndje ka prej vitesh e tillë, dhe vetë IAL është në dijeni dhe u shprehen që do ta shohin me prioritet këtë situatë.

Kurse në total për të tre vitet akademike, pra i gjithë cikli i studimit rezultojnë të regjistruar 369 studentë për të tre profilet. (Sipas Tabeles 13 në Anekse)

Kalueshmeria e studenteve dhe problemet që lidhen me te

Studenti nuk pranohet ne sesionin e pare te provimit të një lende kur ka kryer me shume se 25% mungesa ne seancat mesimore te asaj lende. Ne qofte se ai ka kryer deri ne 50 % mungesa ne seancat mesimore te lendes atehere ai pranohet ne sesionin e dyte. Nese ka kryer mbi 50 % mungesa ne seancat mesimore te lendes shpallet perserites ne ate lende. Departamentet përgjegjëse perfshijnë ne Raportin Vjetor te dhena konkrete per kalueshmerine e studenteve, te specifikuar sipas viteve dhe lendeve perkatese.

Punesimi i te diplomuarve:

Departamentet dhe Fakulteti nuk kanë informacione te detajuara dhe gjithepershiresë nder vite per punesimin e te diplomuarve, megjithëse në raportin e vetëvlerësimit thuhet me të drejtë që niveli i punësimit të të diplomuarëve është i ulët për shkak të ndjekjes në vijueshmëri të studimeve të mëtejshme të studentëve në diplomat e ciklit Master, kryesisht në të njëjtin Kolegj.

Per te diplomuarit e vitit te fundit akademik 2017-2018 në diplomat e nivelit Master, Kolegji, disponon të dhëna për punësimit e tyre në gati 90 % të të gjithë të diplomuarëve.

Procedurat e transferimeve të studimeve

Kolegji lejon dhe pranon transferimet e studenteve brenda programeve te te njejtit cikël studimi, brenda te njejtit institucion, filial apo institucioneve te tjera te arsimit te larte, privat ose publike, vendase (nuk ka raste të transferimit të studimeve nga institucione të huaja), per te vijuar studimet prane Institucionit, duke ju nenshtuar nje procedure qe vlereson dhe lejon pranimin e tyre nepermjet krediteve te akumuluar nga studimet e meparshme sipas procedurave te parashikuara ne rregulloren e transferimeve. në disa vite, numri i studentëve të transferuar nga jashtë në KUB është relativisht më i madh se ai i studentëve që kanë vijuar nga bachelor në Master brënda të njëjtit institucion.

Ky fenomen kërkon një vëmëndje më të madhe për të integruar në vijimin normal të programeve të studimeve, për kandidatë që kanë formim relativisht të ndryshëm të studimeve në nivelin Bachelor. Studentet qe deshirojne te transferohen ne Kolegji Universitar "I Biznesit" (studente ne hyrje) paraqesin nje dosjeaplikimi prane Zyres se Regjistrimit te Studenteve te Kolegji Universitar "I Biznesit". Dosja e çdo studenti që pranohet, shqyrtohet nga Komisioni i Ekuivalentimeve të programeve, i cili perbehet nga 3 (tre) deri ne 5 (pese) pedagogë te brendshem te fakultetit qe ofron programin ku kerkohen te transferohen kreditet.

Dekani i Fakultetit, bazuar ne rregulloren e Institucionit, ka ngritur Komisionin e Transferimeve, i cili brenda dy javesh ben vleresimin per njohjen e plote ose te pjesshme te krediteve te grumbulluara te nje studenti ne programin nga i cili kerkon te transferohet, ne varesi te perputhjes me programin e studimeve te ofruar nga Kolegji Universitar "I Biznesit" ku kerkon te transferohet studenti duke vendosur pranimin ose jo te kerkeses se tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve janë ndërtuar sipas legjislacionit ne fuqi dhe sipas rregullores se programit të studimit.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë, në fillim të çdo viti ka një javë të ambientimit të studentëve me fakultetin.</p> <p>Kolegji ka respektuar kriterin e përgjithshëm të pranimit të studentëve në vitin e parë të studimeve.</p> <p>Institucioni ka edhe kriteret e tjera të përgjithshme, sic eshte intervista e kandidateve, e cila ka peshe te larte ne vleresimin perfundimtar, si dhe zbaton kriteret e percaktuara ne ligj.</p> <p>Deri ne vitin akademik 2017-2018 Fakulteti ka shqyrtuar disa here politikat e pranimit, por nuk ka pasur dhe nuk ka realizuar ndryshime të rëndësishme në kriteret e përgjithshme të pranimit.</p> <p>Ndryshimi i kriterit të përgjithshëm të pranimit, të notës mesatare, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së prurjeve të studentëve në këto programe studimi, cka duket qarte ne nje rritje te lehte te notes mesatare te kandidateve te pranuar nga viti ne vit.</p> <p>Ne vitin akademik 2017-2018 ka pasur kriteret dhe kuota specifike per secilin program studimi, por te padiferencuara per profilet.</p> <p>Per programin Bachelor ne Ekonomi, me tre profile, Kolegji ka percaktuar dhe kriteret e pranimit:</p> <p style="padding-left: 40px;">30% mesatarja e pergjithshme; 30% mesatarja e grup lendeve; 40 % intervista e kandidateve.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p>	<p>Kolegji informon studentet lidhur me procesin e aplikimit, si dhe në fillim të çdo viti te studimeve per organizimin dhe kohezgjatjen e programit te studimit. Forma te tjera</p>

